

Banka e Shqipërisë

LLOGARITË FINANCIARE TË SHQIPËRISË 2020

Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë.

TETOR 2021

PËRMBAJTJA

1.	<i>Hyrje</i>	4
2.	<i>Mjetet dhe detyrimet financiare të sektorëve institucionale</i>	7
3.	<i>Ndërlidhja financiare e sektorëve institucionale</i>	9
4.	<i>Zhvillimet sipas sektorëve institucionale</i>	11
	<i>Ekonomitë familjare</i>	11
	<i>Korporatat jofinanciare</i>	13
	<i>Qeveria e përgjithshme</i>	15
	<i>Korporatat financiare</i>	17
	<i>Korporata depozituese përveç bankës qendrore</i>	20
	<i>Fondet e investimeve</i>	20
	<i>Kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit</i>	21

1. HYRJE

Llogaritë Financiare Kombëtare (në vijim "llogaritë financiare") janë një nga komponentët e llogarive kombëtare dhe mund të përshkruhen si një grup i strukturuar dhe koherent informacioni statistikor, i cili regjistron transaksionet financiare - flukse dhe stoge - midis sektorëve të ndryshëm institucionalë të ekonomisë dhe ndërmjet këtyre sektorëve dhe pjesës tjetër të botës, të ndara sipas llojeve të ndryshme të instrumenteve financiare.

Llogaritë financiare konsiderohen statistika të derivuara pasi ato bazohen në një gamë të gjerë statistikash të tjera, duke përfshirë, për shembull, statistikat e bilancit të pagesave dhe statistikat monetare dhe financiare.

Duke "grumbulluar" burime të shumta informacioni, llogaritë financiare janë të një rëndësie të veçantë për analizën ekonomike, pasi ato bëjnë të mundur përcaktimin sasior të ndikimit të vendimeve financiare të një morie agjentësh ekonomikë (të grupuar në sektorë institucionalë). Veçanërisht e rëndësishme është matja e ndryshimeve në marrëdhëniet ndërsektoriale në një ekonomi, në raste krizash financiare globale dhe/ose krizash të borxhit sovran.

Gjithashtu, duke pasur parasysh se ato ofrojnë një pasqyrë të plotë mbi llojet e investimeve të kryera dhe instrumentet e financimit të përdorura nga agjentët ekonomikë, llogaritë financiare – si një paraqitje sintetike statistikore e strukturës financiare të ekonomisë – kanë një vlerë të konsiderueshme analitike nga pikëpamja e të monitorimit të stabilitetit financiar, pasi mundësojnë, ndër të tjera, analizën e shkallës së ndërmjetësimit të sektorit financiar dhe të strukturës së pasurisë së sektorit privat.

Një nga rezultatet kryesore të llogarive financiare konsiston në llogaritjen e kursimit financiar në sektorë të ndryshëm institucionalë të ekonomisë, d.m.th. diferenca midis investimit në mjete financiare në një periudhë të caktuar dhe detyrimeve të marra në të njëjtën periudhë. Përvetësimi i mjeteve financiare dhe emetimi i detyrimeve në sektorë të caktuar janë të barasvlershëm me kapacitetin kreditues ose kërkesën për huamarrje që rrjedh nga aktiviteti ekonomik në të njëjtin sektor gjatë së njëjtës periudhe. Si rezultat, përveç çdo mospërputhjeje statistikore, bilanci i llogarive financiare dhe jofinanciare do të priret të jetë i barabartë¹.

Përgjegjësia për përpilimin e llogarive financiare i takon Bankës së Shqipërisë, e cila prodhon rregullisht një grup statistikash të nevojshme për përgatitjen e llogarive financiare, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin e saj organik. Nga ana tjetër, për përgatitjen e llogarive kombëtare, ndarja e përgjegjësive institucionale, si edhe mekanizmat e bashkëpunimit për përgatitjen e llogarive kombëtare, përcaktohen në Memorandumin e Bashkëpunimit (MoU)² ndërmjet

¹ Në llogaritë jofinanciare, kapaciteti kreditues ose kërkesa huamarrëse llogaritet për çdo sektor institucional nëpërmjet diferencës ndërmjet burimeve (të ardhurave) dhe punësimit (shpenzimeve).

² Marrëveshja e bashkëpunimit mes Bankës së Shqipërisë, Institutit të Statistikave dhe Ministrisë së Financave u nënshkrua në fund të muajit shtator të vitit 2016.

Bankës së Shqipërisë, Institutit të Statistikave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për sa i përket referencës konceptuale të llogarive financiare, këto statistika përgatiten në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010)³.

Materiali në vijim, në seksionin e dytë prezanton situatën e Llogarive Financiare në vitin 2020, si dhe ecurinë e tyre ndër vite. Seksioni i tretë ndalet në lidhjen ndërmjet sektorëve institucionalë dhe seksioni i katërt paraqet situatën e mjeteve financiare dhe të detyrimeve për çdo sektor të ekonomisë së vendit, pjesë e bllokut të llogarive financiare.

Banka e Shqipërisë publikon statistikat e Llogarive Financiare të Shqipërisë në faqen zyrtare të internetit, në seksionin Statistikat/Llogaritë Financiare/ Aneks Statistikor. Shënimet metodologjike për hartimin e llogarive financiare gjenden gjithashtu të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Informacioni statistikor publikohet i detajuar për secilin sektor dhe nënsektor të ekonomisë në seri kohore 2013-2020.

³ ESA 2010 është një standard i harmonizuar për metodologjinë, përpilimin dhe kohën e shpërndarjes së llogarive kombëtare në vendet e Bashkimit Evropian, i cili korrespondon me versionin evropian të Sistemit Kombëtar të Llogarive 2008 (NSA 2008), i përpiluar nën drejtimin e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, përkatësisht Eurostat, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore.

KOMENTE TË PËRGJITHSHME PËR LLOGARITË FINANCIARE TË SHQIPËRISË

Sistemi i llogarive kombëtare i klasifikon njësitë⁴ institucionale në bazë të aktivitetit kryesor ekonomik dhe sipas rolit që luajnë në ekonominë e vendit. Sektorë institucionale janë: korporatat jofinanciare, korporatat financiare, qeveria e përgjithshme dhe ekonomitë familjare dhe institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të familjeve.

Korporatat jofinanciare dhe korporatat financiare përfshijnë njëkohësisht korporatat private dhe ato publike (me aksione të zotëruara nga qeveria).

Qeveria e përgjithshme përfshin ato njësi institucionale, të cilat janë prodhues jotregu ose të cilat kanë funksion kryesor rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare dhe ku më shumë se 50% e aktivitetit të tyre financohet nga buxheti i qeverisë. Sektori i qeverisë së përgjithshme përbëhet nga tre nënsektorë: qeveria qendrore, qeveria lokale dhe fondet e sigurimeve shoqërore.

Sektori i ekonomive familjare përbëhet nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë. Në sektorin e institucioneve jo me qëllim fitimi në shërbim të familjeve përfshihen njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk prodhojnë për tregun. Institucione të tilla i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse.

Mjetet financiare dhe detyrimet klasifikohen në instrumentet financiarë: ari monetar dhe SDR, monedha dhe depozitat, letrat me vlerë të borxhit, hua, kapitali dhe aksionet në fonde investimi, sigurime dhe skemat e pensioneve, derivativë financiarë dhe llogari të tjera të arkëtueshme/të pagueshme.

⁴ Një njësi institucionale karakterizohet nga autonomia e vendimmarrjes në çështjet ekonomike, ku ose ruan një strukturë të plotë të llogarive ose është në gjendje të përpilojë një të tillë. Duhet të theksohet se koncepti themelor i ndarjes së ekonomisë në sektorë institucionale sipas ESA 2010 ndryshon nga ai i klasifikimit të njësive ekonomike prodhuese sipas NACE (Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike).

2. MJETET DHE DETYRIMET FINANCIARE TË SEKTORËVE INSTITUCIONALE

Grafiku 1 dhe tabela 1 prezantojnë llogaritë financiare të Shqipërisë në vitin 2020, të paraqitura në mjete financiare dhe detyrime të sektorëve institucionalë, të detajuara në instrumente financiare.

Mjetet dhe detyrimet financiare të sektorit të korporatave financiare paraqiten në volume të konsiderueshme krahasimisht me ato të sektorëve të tjerë. Kjo për shkak se institucionet e përfshira në këtë sektor veprojnë si ndërmjetës financiarë. Pozicionet me jashtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të korporatave financiare.

Për sektorin e korporatave financiare, niveli i mjeteve financiare dhe detyrimeve është pothuajse i balancuar. Ndryshe paraqitet situata e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare. Për ekonomitë familjare, mjetet financiare në thelb tejkalojnë detyrimet, kryesisht për shkak të nivelit të lartë të investimeve në formën e depozitave, si dhe investimeve në formën e pjesëmarrjeve në kapitalin e korporatave jofinanciare.

Për korporatat jofinanciare, detyrimet tejkalojnë pasuritë financiare në mënyrë të konsiderueshme. Kjo për faktin se: së pari, krahas kredive dhe letrave me vlerë të borxhit, detyrimet përfshijnë gjithashtu vlerën e tregut të aksioneve të emetuara nga korporatat; dhe së dyti, mjetet jofinanciare të financuara nëpërmjet kapitalit dhe kapitalit të huazuar nuk regjistrohen në llogaritë financiare. Më tej, paraqitja e të dhënave në llogaritë financiare bëhet në baza të pakonsoliduara, d.m.th. mjetet financiare dhe detyrimet brenda një sektori nuk netohen përkundrejt njëri-tjetrit, dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e korporatave jofinanciare.


Krahasimisht me volumin monetar të sektorëve të tjerë, mjetet financiare dhe detyrimet e sektorit të qeverisë së përgjithshme janë të ulëta (përkatësisht 9% dhe 19% të totalit të ekonomisë së brendshme).

Totali i mjeteve financiare të sektorëve të brendshëm të ekonomisë (sektorëve rezidentë), në vitin 2020, vlerësohet në 6,470 miliardë lekë, në rritje vjetore me 6.6%. Totali i detyrimeve u zgjerua me 7% në terma vjetorë, në nivelin 7,335 miliardë lekë. Në dimensionin e ekspozimit neto⁵, ekonomia shqiptare, në fund të vitit 2020, pozicionohet në huamarrës neto me rreth -885⁶ miliardë lekë. Ky nivel është rreth 10% më i lartë krahasuar me pozicionin prej -804 miliardë lekë në vitin 2019.

Seksioni 4 në vijim ofron një tablo më të detajuar mbi zhvillimet në mjete dhe detyrime financiare të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

⁵ Diferenca mes mjeteve dhe detyrimeve financiare.

⁶ Në përputhje me metodologjinë, ka një diferencë midis pozicionit financiar neto të ekonomisë së vendit dhe pozicionit financiar neto të sektorit jorezident meqënëse ari monetar nuk ka kundërpartit dhe regjistrohet vetëm si mjet i bankës qendrore.



*Tabelë 1. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të sektorëve institucionalë, 2020
Në miliardë lekë*

	Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare
Mjete financiare				
Ari monetar dhe SDR	-	41	-	-
Monedha dhe depozita	285	603	54	1,183
Letra me vlerë të borxhit	28	929	0	77
Hua	78	727	59	3
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	110	40	223	742
Sigurime dhe skemat e pensioneve	18	7	..	6
Derivativë financiarë	..	0	0	..
Llogari të tjera të arkëtueshme	825	26	273	131
Totali	1,345	2,375	610	2,141
Detyrime				
Ari monetar dhe SDR	-	7	-	-
Monedha dhe depozita	-	1,905	-	-
Letra me vlerë të borxhit	29	7	732	-
Hua	728	88	404	239
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	1,579	309	-	0
Sigurime dhe skema pensioni	-	26	-	-
Derivativë financiarë	..	0	-	..
Llogari të tjera të pagueshme	967	27	296	11
Totali	3,303	2,369	1,433	250

1 Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlerë e papërfillshme


- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. NDËRLIDHJA FINANCIARE E SEKTORËVE INSTITUCIONALË

Ky seksion synon të analizojë modelet e financimit të vendosura midis sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, si dhe mes tyre dhe “pjesës tjetër të botës” ose sektorit jorezident. Për këtë qëllim, informacioni mbi gjendjen financiare kombinohet me konceptin e rrjedhës së fondeve “nga kush-tek kush”⁷, në mënyrë të tillë që të mundësojë matjen e marrëdhënieve financiare ndërsektoriale në ekonominë shqiptare dhe shkallën e ndërveprimit të saj me botën (sektori jorezident). Grafiku 2 paraqet ndërlidhjen financiare të sektorëve institucionalë. Ndërtimi dhe interpretimi i tij paraqitet në shënimin në vijim.



Në dimensionin e ekspozimit neto, ekonomitë familjare dhe sektori jorezident pozicionohen në kreditorë ose huadhënës neto, ndërkohë që, korporatat jofinanciare dhe qeveria e përgjithshme vijnë në pozicion debitor ose huamarrës neto⁸. Për shkak të natyrës së biznesit, korporatat financiare shfaqin një pozicion neto shumë të ulët.

Në vitin 2020, pozicioni debitor i ekonomisë shqiptare arriti në 902 miliardë lekë, sikundër mund të shihet nga vlera pozitive e kapacitetit të kreditimit të pjesës tjetër të botës (sektori jorezident), e cila ishte huadhënësi i sektorëve rezidentë në tërësi. Megjithatë, secili sektor paraqiti individualisht vlera të dallueshme për nevojat e financimit dhe madje edhe kapacitetin e huadhënies. Pjesa tjetër e botës financoi kryesisht korporatat jofinanciare dhe qeverinë e përgjithshme, të ilustruara nga drejtimi i shigjetave. Sektori financiar i është rikthyer rolit të tij tradicional në ndërmjetesim si huadhënës neto, në një vlerë prej +6 mld lekësh, duke marrë fonde nga ekonomitë familjare dhe duke e kanalizuar këtë financim në drejtim të sektorit jorezident, korporatave

⁷ Për më gjerësisht, shpjegimi në botimin e Bankës së Shqipërisë “Statistikat e llogarive financiare për vitin 2017” dhjetor 2018, në seksionin metodologjik 1.5 Matrica ‘nga kush - tek kush’ dhe rrjedha e fondeve.

⁸ Më gjerësisht, analiza e zhvillimeve të llogarive financiare për çdo sektor në seksionin 4.

jofinanciare dhe qeverisë. Duhet të theksohet, megjithatë, se ka një asimetri të qartë në magnitudë midis burimeve të financimit të brendshëm dhe të jashtëm. Korporatat financiare kanë financuar kryesisht sektorin jorezident shprehur kryesisht në rritje të investimeve të tyre të letrave me vlerë afatgjata dhe sektorin e qeverisë sikurse mbajnë peshën më të madhe të letrave me vlerë të qeverisë. I gjithë sektori i korporatave financiare ka financuar rreth 48% të totalit të borxhit të qeverisë.

Sektori financiar, sektori korporata jofinanciare dhe ai jorezident evidentohen si sektorët kryesorë për sa i përket ekspozimit bruto⁹ (vektorët më të theksuar).

Gjithashtu, shkalla e integrit me jashtë (segmenti lidhës me sektorin jorezident) paraqitet e lartë për korporatat financiare me një total të ekspozimit bruto prej 1,204 miliardë lekësh, rrjedhojë e investimeve në letra me vlerë, marrëdhënieve interbankare, depozitave të emigrantëve, si dhe pjesëmarrjes së huaj të kapitalit në sektorin bankar. I ilustruar me të dhënat në paraqitjen e llogarive financiare sipas matricës “nga kush – tek kush”, ekspozimi bruto i sektorit të korporatave financiare me jashtë (jorezidentët) përlllogaritet si shumator i mjeteve (868) dhe detyrimeve (336) të korporatave financiare me jorezidentët (Tabela 2).

Tabelë 2. Paraqitja e llogarive financiare në matricën “nga kush - tek kush” - viti 2020, në miliardë lekë

		Sektori Kreditor				
		Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare	Jorezidentët
Sektori debitor	Korporatat jofinanciare	607	410	516	700	1,070
	Korporatat financiare	335	301	93	1,300	336
	Qeveria e përgjithshme	279	550	n/a	93	510
	Ekonomitë familjare	5	245	-	n/a	-
	Jorezidentët	119	868	-	48	n/a

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për korporatat jofinanciare, totali i ekspozimit bruto me jashtë vlerësohet 1,189 miliardë lekë, dhe vjen kryesisht si pasojë e pjesëmarrjes në kapital në formën e investimeve të huaja direkte.

Qeveria e përgjithshme ka një vlerë të ekspozimit bruto me jashtë prej 510 miliardë lekësh, rrjedhojë e nivelit të lartë të financimit të huaj në borxhin e qeverisë.

Financimi brenda sektorit – si në vlerë absolute, ashtu edhe në përqindje ndaj ekspozimit total bruto – vërehet më i lartë në sektorin e korporatave jofinanciare (në nivelin 607 miliardë lekë).

⁹ Totali i mjeteve dhe detyrimeve financiare me sektorë të tjerë.

4. ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALË


EKONOMITË FAMILJARE¹⁰

Ekonomitë familjare zotërojnë rreth 33% të totalit të mjeteve financiare të brendshme. Në harkun kohor një viti, mjetet e këtij sektori u zgjeruan me rreth 122 miliardë lekë dhe në fund të 2020 shënojnë 2,141 miliardë lekë.


Mjetet financiare të ekonomive familjare tejkalojnë ndjeshëm detyrimet e këtij sektori. Instrumenti kryesor i përdorur nga ekonomitë familjare vijon të jetë “monedha dhe depozitat”, i cili përfaqëson 55% të mjeteve financiare të këtij sektori, në fund të 2020. Ndërkohë “kapitali dhe aksione në fonde investimi” përbën 35% të totalit të mjeteve financiare, ndjekur nga “letra me vlerë të borxhit” 4%.

Zgjerimi vjetor në mjete financiare të këtij sektori i atribuohet në masën më të madhe rritjes së investimeve në “monedha dhe depozitat” prej 98 miliardë lekësh, ndjekur nga zgjerimi i “kapital dhe aksione në fonde investimi” prej 26 miliardë lekësh.


Grafik 3. Mjete financiare të ekonomive familjare




Grafik 4. Mjete financiare të ekonomive familjare: ndryshimi i stokut



Grafik 5. Përbërja e mjeteve financiare të ekonomive familjare, 2020



Grafik 6. Përbërja e detyrimeve të ekonomive familjare, 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

¹⁰ Përfshirë institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve (NPISH), të tilla si organizatat e ndihmës sociale, kishat, sindikatat, partitë politike dhe klubet argëtuese, të cilat u ofrojnë familjeve shërbime jotregu. Mjetet dhe detyrimet financiare të NPISH vlerësohen në më pak se 1% të totalit të aktiveve financiare dhe detyrimeve të ekonomisë familjare. Kur interpretohen të dhënat për mjetet financiare të këtij sektori duhet të konsiderojmë se të dhënat ekonomike janë në nivel të agreguar. Llogaritë financiare nuk disponojnë informacion në lidhje me mjetet financiare individuale të familjeve apo shpërndarjen e pasurisë brenda sektorit.

Tabelë 3. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të ekonomive familjare, në miliardë lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Mjete financiare								
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	915	938	955	984	996	1,022	1,085	1,183
Letra me vlerë të borxhit	72	76	83	80	92	96	86	77
Hua	4	5	2	2	3	3	3	3
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	569	569	668	614	568	681	716	742
Sigurime dhe skemat e pensioneve	1	2	2	3	3	4	5	6
Derivatë financiare
Llogari të tjera të arkëtueshme	114	176	80	99	101	98	125	131
Totali	1,675	1,767	1,792	1,781	1,764	1,904	2,019	2,141
Detyrime								
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua	165	167	176	183	195	207	224	239
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	-	-	-	-	-	-	-	-
Sigurime dhe skemat e pensioneve	-	-	-	-	-	-	-	-
Derivatë financiare
Llogari të tjera të pagueshme	27	23	24	11	11	12	12	11
Totali	192	190	200	194	206	218	236	250

1 Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlerë e papërfillshme


- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Detyrimet e ekonomive familjare përbëhen kryesisht nga kreditë hipotekare, të cilat zënë peshën më të madhe të totalit (rreth 53%), ndjekur nga kreditë konsumatore dhe huatë e tjera.

Detyrimi në "hua" i ekonomive familjare, në fund të vitit 2020, u zgjerua me +14.6 miliardë lekë dhe shënon vlerën e 239 miliardë lekëve. Transaksioni (fluksi) në "hua", pastruar për efekt të kursit të këmbimit dhe ndryshime të tjera, gjatë vitit 2020 shënon një zgjerim prej +15.7 miliardë lekësh. Detyrimi në "hua" ndaj sektorit të korporatave depozituese, përveç bankës qendrore (bankave të nivelit të dytë), u rrit me 13.9 miliardë lekë në nivelin e 208 miliardë lekë, ndërsa "huatë" me institucionet e tjera financiare u zgjeruan me 0,9 miliardë lekë, në nivelin e 29 miliardë lekë.



KORPORATAT JOFINANCIARE


Detyrimet e korporatave jofinanciare (ose ndryshe bizneset) janë dukshëm në nivel shumë më të lartë se mjetet e tyre. Kjo, për arsye se mjetet jofinanciare nuk raportohen në llogaritë financiare. Për më tepër, krahas huave dhe letrave me vlerë të borxhit, detyrimet përfshijnë edhe aksionet e emetuara nga korporatat.

Në fund të vitit 2020, biznesi ose korporatat jofinanciare zotërojnë rreth 1,345 miliardë lekë mjete financiare, shifër e cila përbën rreth 21% të totalit të mjeteve të brendshme financiare.

Mjetet financiare të korporatave jofinanciare janë në masën 21% në "monedha dhe depozita", ndjekur nga "aksione dhe kapital tjetër" 8% dhe "hua" 6%. Zotërimet në "sigurime dhe skema pensioni" dhe "letrave me vlerë të borxhit" së bashku përbëjnë vetëm 3.5% të aktiveve financiare. Instrumenti "llogari të tjera të arkëtueshme" është vlerësuar në rreth 61% të totalit të aktiveve financiare të korporatave jofinanciare. Ky zë krahas kredive tregtare, regjistron edhe pretendime të tjera përkundrejt sektorëve të lidhur.

Investimet e sektorit në "monedha dhe depozita" u rritën me 26.4 miliardë lekë në nivelin 285 miliardë lekë në fund të vitit 2020. Mjetet financiare në formën e "huasë" u rritën me 3 miliardë lekë, në nivelin 78 miliardë lekë: huadhënia brenda sektorit u zgjerua lehtësisht me 4.2 miliardë lekë, ndërkohë që huadhënia ndaj sektorit jorezident u tkurr me 1.3 miliardë lekë. Investimet në "aksione dhe kapital tjetër" u rritën me 6.7 miliardë lekë në nivelin 110

miliardë lekë. Investimet në “letra me vlerë të borxhit” u rritën në drejtim të zgjerimit të investimit në tituj të qeverisë shqiptare.



Tabelë 4. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të korporatave jofinanciare, në miliardë lekë.

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Mjete financiare								
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	143	177	186	247	275	254	258	285
Letra me vlerë të borxhit	-	57	62	61	47	26	28	28
Hua	187	73	66	65	57	69	75	78
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	59	58	40	63	68	78	104	110
Sigurime dhe skemat e pensioneve	7	9	10	14	14	14	20	18
Derivativë financiarë	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera të arkëtueshme	666	699	672	629	612	600	816	825
Totali	1,063	1,073	1,036	1,078	1,073	1,042	1,301	1,345
Detyrime								
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	47	48	37	39	39	35	33	29
Hua	764	741	704	704	687	659	686	728
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	975	987	1,083	1,118	1,221	1,380	1,487	1,579
Sigurime dhe skemat e pensioneve	-	-	-	-	-	-	-	-
Derivativë financiarë
Llogari të tjera të pagueshme	812	942	815	794	735	780	926	967
Totali	2,598	2,718	2,639	2,653	2,681	2,854	3,131	3,303

1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme


.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2020, struktura e detyrimeve të korporatave jofinanciare paraqitet si në vijim: “aksione dhe kapital tjetër” (48%), “llogari të tjera të pagueshme” (29%), “huatë” (22%) dhe “letra me vlerë të borxhit” (1%).

Detyrimet në “aksione dhe kapital tjetër” janë kryesisht me investitorët e huaj dhe ekonominë familjare, përkatësisht në masën 45% dhe 38%. Në vitin 2020, ky zë u rrit me 92 miliardë lekë në nivelin 1,579 miliardë lekë. Kjo rritje në masën me të madhe u diktua nga zgjerimi i pjesëmarrjes në kapital të sektorit jorezident (me 71 miliardë lekë).

Detyrimet në “hua” të korporatave jofinanciare u rritën dhe në fund të vitit 2020 shënojnë 728 miliardë lekë. Ky zhvillim i atribuohet së bashku, zgjerimit të detyrimit ndaj sektorit të korporatave të tjera depozituese (detyrimet të kredisë në sektorin bankar) me rreth 26 miliardë lekë, rritjes së detyrimit ndaj sektorit të jorezidentëve me rreth 10.8 miliardë lekë, si dhe në masë më të vogël rritjes së detyrimit në formën e huasë brenda sektorit (hua ndërkompani), me rreth 4.2 miliardë lekë.



QEVERIA E PËRGJITHSHME


Të dhënat e sektorit të qeverisë së përgjithshme bazohen në informacionin e raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe nga të dhënat kundërpartit. Ky sektor paraqet të dhënat e konsoliduara për nënsektorin e qeverisë qendrore, nënsektorin e qeverisë lokale, fondet e sigurimeve shoqërore dhe ato të sigurimeve shëndetësore. Të dhënat e llogarive financiare të sektorit të qeverisë së përgjithshme përfshijnë kryesisht të dhënat e njërive buxhetore, kjo për të ruajtur harmonizimin me statistikën e tjera të publikuara, si statistikën financiare të qeverisë (GFS) dhe llogaritë kombëtare¹¹.

Mjetet financiare në zotërim të qeverisë së përgjithshme vlerësohen në 610 miliardë lekë ose 9.4% të totalit të sektorëve të brendshëm të ekonomisë. Në terma vjetorë, ato u zgjeruan me 4%.

Zotërimet financiare të qeverisë janë kryesisht në formën e pjesëmarrjes në “aksione dhe kapital tjetër”. Në fund të vitit 2020, këto zotërimet shënojnë 223 miliardë lekë, ku rreth 188.3 miliardë lekë janë aksione/pjesëmarrje në kapital në korporata publike jofinanciare dhe rreth 33.7 miliardë lekë është kapitali i bankës qendrore (llogaritë kapitale). Kapitali i bankës qendrore

¹¹ Nga njësitë ekstra-buxhetore është përfshirë në të dhënat e qeverisë vetëm Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).

në statistikat makroekonomike vlerësohet si pasuri publike dhe regjistrohet në sektorin e qeverisë së përgjithshme. Mjetet financiare në formën e “monedhave dhe depozitave”, gjatë vitit 2020 ranë me 5.7% në nivelin 54 miliardë lekë. Rënia u ndikua nga rënia e depozitave të transferueshme në bankën qendrore.



Tabelë 5. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të qeverisë së përgjithshme, në miliardë lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Mjete financiare								
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	28	23	37	34	48	78	57	54
Letra me vlerë të borxhit	0	0	0	0	0	0	0	0
Hua	58	59	36	42	49	58	59	59
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	226	215	237	238	237	217	225	223
Sigurime dhe skemat e pensioneve
Derivatëve financiarë	0	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	169	166	218	224	172	196	245	273
Totali	482	464	528	538	506	548	585	610
Detyrime								
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	542	569	557	562	583	628	640	732
Hua	292	343	406	422	434	407	399	404
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	-	-	-	-	-	-	-	-
Sigurime dhe skemat e pensioneve	-	-	-	-	-	-	-	-
Derivatëve financiarë	-	-	-	-	-	-	-	0
Llogari të tjera të pagueshme	140	118	179	203	190	160	297	296
Totali	974	1,031	1,142	1,187	1,207	1,195	1,335	1,433

1 Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlera e papërfillshme


- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2020, detyrimet e qeverisë së përgjithshme vlerësohen në nivelin 1,433 miliardë lekë. Mëse gjysma e detyrimeve (51%) përbëhet nga "letrat me vlerë të borxhit". Stoku i "letrave me vlerë të qeverisë" përlogaritet në rreth 732 miliardë lekë¹² nga 640 miliardë në fund të vitit 2019. Financuesi kryesor i borxhit të qeverisë së përgjithshme (hua dhe letra me vlerë) është sektori i jorzidentëve, i cili mban rreth 45% të totalit, pasuar nga nënsektori i korporatave të tjera depozituese (bankat) në rreth 37%. I gjithë sektori i korporatave financiare ka financuar rreth 48% të totalit të borxhit të qeverisë. Detyrimet në llogari të tjera të pagueshme të qeverisë së përgjithshme për vitin 2020 u vlerësuan në rreth 296 miliardë lekë¹³.

Grafik 20. Detyrime të qeverisë së përgjithshme: letra me vlerë



Grafik 21. Detyrime të qeverisë së përgjithshme: ndryshimi i stokut të letrave me vlerë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KORPORATAT FINANCIARE

Mjetet financiare të korporatave financiare në fund të vitit 2020 shënojnë 2,375 miliardë lekë dhe përfaqësojnë në masën 36.7% totalin e mjeteve të brendshme financiare të Shqipërisë.

Sektori i korporatave financiare¹⁴ përbëhet nga nënsektorët: banka qendrore (25%), korporata depozituese përveç bankës qendrore (67%), fondet e investimit (3%), shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit (2%) dhe institucionet e tjera financiare (3%).

Në masën më të madhe, zotërimet financiare të sektorit të korporatave financiare janë në formën e investimeve në "letra me vlerë të borxhit", me rreth 39% të totalit të mjeteve financiare në fund të vitit 2020. Zotërimet në "hua" dhe "monedha e depozita", gjithashtu zënë një pjesë të konsiderueshme të totalit të mjeteve financiare të këtij sektori, përkatësisht me 31% dhe 25%.

¹² Në mungesë të informacionit mbi vlerën e tregut, vlera e stokut të letrave me vlerë të qeverisë së përgjithshme për letrat me vlerë të tregtuara në tregun e brendshëm është vlerësuar në vlerë nominale (çmimi i emimit plus interesat e përlogaritura) si një përafrim më i saktë i vlerësimit për vlerën e tregut të këtij instrumenti.


¹³ Për më shumë mbi vlerësimet e të dhënave të qeverisë së përgjithshme në këtë instrument financiar shiko dokumentin metadata.

¹⁴ Lista e detajuar gjendet në lidhjen https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Lista_e_njesive_institucionale_te_klasifikuara_ne_sektorin_financiar_shqiptar_date_31_12_2020_18213.xlsx


Në krahun e detyrimeve, instrumenti kryesor është “monedha e depozita”, në rreth 80% të totalit. Detyrimet në “kapital e aksione në fonde investimi” zënë 13% të totalit të detyrimeve të korporatave financiare.

Nënsektori i korporatave depozituese përveç bankës qendrore (sektori bankar) është dominues në performancën e të gjithë sektorit financiar. Ai zë mesatarisht 67% të totalit të mjeteve të sektorit dhe 25% të totalit të ekonomisë vendase. “Hua” dhe “letrat me vlerë të borxhit” janë instrumentet që dominojnë mjetet financiare të sektorit bankar, dhe në masë më të vogël “monedha dhe depozita”. Për nënsektorin e ndërmjetësve të tjerë financiarë, instrumentet financiare më të rëndësishme, si në mjete dhe në detyrime janë “huaja” dhe “kapitali dhe aksione në fonde investimi”.

Grafik 22. Mjete financiare të korporatave financiare – instrumentet kryesore



Grafik 23. Detyrime të korporatave financiare – instrumentet kryesore




Grafik 24. Përbërja e mjeteve financiare të korporatave financiare, 2020



- Ari monetar dhe SDR 2%
- Monedhat dhe depozitat 25%
- Letra me vlerë të borxhit 39%
- Huatë 32%
- Kapitali dhe aksionet në fondet e investimit 16%

Grafik 25. Përbërja e detyrimeve të korporatave financiare, 2020



- Ari monetar dhe SDR 0%
- Monedhat dhe depozitat 80%
- Letra me vlerë të borxhit 0%
- Huatë 4%
- Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit 13%
- Llogari të tjera të pagueshme 1%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të korporatave financiare, në miliardë lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Mjete financiare								
Ari monetar dhe SDR	17	19	31	27	26	20	24	41
Monedha dhe depozita	317	328	445	461	541	579	558	603
Letra me vlerë të borxhit	749	809	768	802	744	763	827	929
Hua	635	663	649	696	702	658	687	727
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	14	14	19	22	28	30	34	40
Sigurime dhe skemat e pensione	4	4	5	5	5	5	9	7
Derivativë financiarë	0	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	17	16	16	23	26	26	27	26
Totali	1,753	1,853	1,933	2,036	2,073	2,081	2,166	2,375
Detyrime								
Ari monetar dhe SDR	7	8	8	8	7	7	7	7
Monedha dhe depozita	1,363	1,430	1,508	1,580	1,629	1,669	1,721	1,905
Letra me vlerë të borxhit	0	0	6	6	7	7	8	7
Hua	76	81	58	77	86	81	97	88
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	226	258	283	293	295	277	292	309
Sigurime dhe skemat e pensione	10	12	16	18	19	20	26	26
Derivativë financiarë	0	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	23	18	21	18	16	20	22	27
Totali	1,706	1,807	1,901	2,000	2,060	2,080	2,173	2,369

1 Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlerë e papërfillshme

- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Mjete financiare dhe detyrimeve të nënsektorëve të korporatave financiare, 2020, në miliardë lekë

	Banka Qendrore	Korporata të tjera depozituese	Fondet e investimit	Ndërmjetësit e tjerë financiarë	Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit
Mjete financiare					
Ari monetar dhe SDR	41	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	200	367	5	18	13
Letra me vlerë të borxhit	310	553	59	0	8
Hua	35	654	1	37	0
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	0	18	2	16	4
Sigurime dhe skemat e pensione	7
Derivativë financiarë	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	4	10	0	6	5
Totali	590	1603	68	78	36
Detyrime					
Ari monetar dhe SDR	7	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	570	1335	-	0	-
Letra me vlerë të borxhit	-	7	-	0	-
Hua	0	54	-	34	0
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	34	171	67	25	13
Sigurime dhe skemat e pensione	-	-	-	-	26
Derivativë financiarë	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	0	15	0	7	4
Totali	611	1582	68	67	42

1 Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlerë e papërfillshme

- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.


KORPORATA DEPOZITUESE PËRVEÇ BANKËS QENDRORE

Mjetet financiare të korporatave depozituese përveç bankës qendrore (sektori bankar) u zgjeruan me 117 miliardë lekë dhe në fund të vitit 2020 shënojnë 1,603 miliardë lekë.

Instrumenti financiar “hua” mban pjesën më të madhe të mjeteve financiare të këtij nënsektori, me përafërsisht 41% të totalit. Gjatë vitit 2020, këto zotërime u rritën me 42.8 miliardë lekë në nivelin 654 miliardë lekë. Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga zgjerimi i huasë akorduar sektorit të korporatave jofinanciare me 26 miliardë lekë dhe sektorit të ekonomive familjare me rreth 14 miliardë lekë. Kredia akorduar sektorit jorezident shënoi rritje në terma nominalë me 5.4 miliardë lekë, në ndryshim nga një vit më parë ku shënoi rënie me 17.3 miliardë lekë. Në fund të 2020, kjo kredi përfaqëson rreth 7% të portofolit të kredisë bankare nga 6% që shënonte në fund të vitit 2019.

Portofoli në “letra me vlerë të borxhit”, i cili përfaqëson rreth 34% të mjeteve financiare të sektorit bankar, u zgjerua me 73 miliardë lekë ose 15% në terma vjetorë. Në fund të vitit 2020, teprica në “letra me vlerë të borxhit” shënon 553 miliardë lekë. Investimet në letra me vlerë afatgjata të jorezidentëve mbeten atraktive dhe gjatë vitit u rritën me rreth 34%, duke zgjeruar peshën e tyre në totalin e letrave me vlerë në nivelin 24%.

Në krahun e detyrimeve, “monedha dhe depozita” përbëjnë komponentin kryesor të emetimit të detyrimeve financiare të sektorit bankar, në masën 84% të totalit në fund të vitit 2020. Depozitat bankare gjatë këtij viti, u zgjeruan me 95 miliardë lekë, në nivelin 1,334.8 miliardë lekë. Ky zhvillim është pasojë e zgjerimit të bazës së depozitave të sektorit të brendshëm të ekonomisë.




FONDET E INVESTIMEVE

Gjatë vitit 2020, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre shtatë fonde investimi, dy prej të cilave e kanë nisur aktivitetin e tyre gjatë këtij viti.

Në fund të vitit 2020, mjetet financiare të fondeve të investimeve shënojnë 67.5 miliardë lekë duke shënuar një rënie të lehtë nga 68 miliardë lekë në fund të 2019. Ecuria e këtij tregu mbetet nën ndikimin e një ambienti me norma të ulëta të interesit.

Në aspektin e politikës së investimeve, ato dominohen kryesisht nga investime në letra me vlerë të borxhit të qeverisë shqiptare në masën 85%. Ky portofol investimi gjatë vitit u zgjerua në terma vjetorë me rreth 2% dhe në fund të 2020 shënon vlerën 59 miliardë lekë. Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë vlerësohen në nivelin 47.8 miliardë lekë.



Nga ana e detyrimeve, në konsiderata të llojit të ndërmjetësimit financiar që kryhet nga fondet e investimeve, detyrimi kryesor financiar i këtij nënsektori është në kuota (njësi) të fondit të investimit, të cilat përbëjnë 99.8 % të detyrimeve financiare, në fund të vitit 2020. Në terma absolutë, stoku i këtij instrumenti ka ruajtur pothuajse të njëjtin nivel me atë të shënuar një vit më parë, pas një rritjeje prej 4% të shënuar në vitin 2019. Investitorë në fondet e investimeve janë kryesisht individët.

KOMPANITË E SIGURIMIT DHE FONDET E PENSIONIT

Tregu shqiptar i sigurimeve vijon me një ritëm relativisht të qëndrueshëm zgjerimi, dhe numri i shoqërive operuese në tregun e sigurimeve ka mbetur i njëjtë edhe gjatë këtij viti, në 12 kompani.

Për vitin 2020, mjetet financiare të kompanive të sigurimit dhe ato të fondeve të pensionit shënuan në total 36.3 miliardë lekë, duke shënuar një rënie vjetore me rreth 1%. Së bashku, këta nënsektorë përfaqësojnë vetëm 2% në totalin e mjeteve të korporatave financiare.

“Monedha dhe depozita”, si dhe “letra me vlerë të borxhit” janë dy instrumentet më të rëndësishme financiare të mbajtura nga këta nënsektorë. Në fund të 2020, teprica në “monedha dhe depozita” shënoi 13 miliardë lekë dhe vlerësohet në rritje prej 9%.

Në krahun e detyrimeve, rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor janë detyrimet kryesore financiare të nënsektorit të kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit. Në fund të vitit 2020, teprica e këtyre detyrimeve shënon 25.7 miliardë lekë dhe përbën 61% të totalit të detyrimeve financiare. Peshën kryesore të këtij detyrimi e përbëjnë rezervat e sigurimit të jo-jetës, me 78% të totalit.

Aksione ose njësi të fondeve të investimit ose llogaria e kapitaleve të veta, është një tjetër instrument i rëndësishëm financiar në totalin e detyrimeve financiare të këtij nënsektori (me rreth 30%).

